



KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

PLANI STRATEGJIK

PËR PERIUDHËN 2021 – 2024

Plani strategjik i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) për periudhën 2021-2024 është pjesë e projektit „Mbështetje e Reformave Zgjedhore“ e Ambasadës së Zvicrës, të implementuar nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES) dhe Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë (KRNM). Mendimet, qëndrimet dhe përmbajtjet e shprehura nuk pasqyrojnë qëndrimet dhe mendimet e donatorit, projektit dhe implementuesit.

PËRMBAJTJA

HYRJE	7
QËLLIMI I PLANIT STRATEGJIK TË KSHZ-SË PËR PERIUDHËN 2021 – 2024	8
PASQYRË E PRIORITETEVE DHE OBJEKTIVAVE PËR PERIUDHËN 2021-2024	9
PASQYRË E AKTIVITETEVE DHE INDIKATORËVE PËR PERIUDHËN 2021-2024	14
KORNIZA PËR MONITORIM DHE REVIZION TË PLANIT STRATEGJIK	23
SHTOJCAT	25
PRINCIPET E PUNËS SË KSHZ-SË	26
KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE E KSHZ-SË	31



FJALIMI HYRËS

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) është institucion i pavarur dhe profesional i cili gjatë punës së tij udhëhiqet në pajtim me Kushtetutën , ligjet, konventat dhe standardet ndërkombëtare të pranuar përgjithësisht. Duke ndjekur trendet botërore , KSHZ-ja, vendos teknologji të reja në procesin zgjedhor, e gjithë kjo me qëllim që të gjithë palëve pjesmarrëse në procesin zgjedhor t'u mundësohet qasje e barabartë në realizimin e të drejtës së tyre zgjedhore , si edhe zbatim të suksesshëm të zgjedhjeve.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve edhe në kushte pandemie punon në kontinuitet dhe i fokusuar. Edhe në këto kushte përgatiti , Propozim - planin strategjik, i cili përfshin periudhën 2021-2024, dhe i cili paraqet vazhdimësi të planeve strategjike të mëparshme, me plotësime të cilat paraqesin udhërrëfyes të rëndësishëm për drejtimet strategjike , objektivat dhe aktivitetet. Unë, si kryetar sëbashku me anëtarët e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve jemi të vetëdijshëm për sfidën para së cilës gjindemi dhe kjo është arsyeja që përgatitëm plan strategjik, i cili do t'u përgjigjet të gjitha pyetjeve të hapura, duke ndjekur të gjitha parimet dhe normat universale.

Plani strategjik për periudhën 2021-2024 është produkt i përpjekjeve, bisedave dhe sugjerimeve nga të gjithë palët që janë përfshirë në procesin zgjedhor e gjithë kjo me qëllim të organizimit të zgjedhjeve të drejta të lira dhe demokratike. Qëllimi kryesor i këtij plani është të vendosë strategji katërvjeçare për përmirsimin e punës së KSHZ-së, përmes mbajtjes së një sistemi zgjedhor të besueshëm, përmirsim të vazhdueshëm të procesit zgjedhor dhe përkrahje të vazhdueshme të të gjithë pjesmarrësve në zgjedhje në realizimin e të drejtës së tyre zgjedhore.

Për të arritur këtë, pjesëmarrësit indefikuan shtatë prioritete, gjegjësisht rritjen e cilësisë së akteve nënligjore dhe zbatimin efektiv të tyre, përmirsimin e mënyrës dhe procedurës për udhëheqjen e listës zgjedhoreo, pastaj përmirsimin e efikasitetit të aktiviteteve ndërmejt aktiviteteve zgjedhore, ngritjen e vetëdijes, njohurive dhe besimit të qytetarëve në procesin zgjedhor, përmirsimin e njohurive dhe aftësive të administratës zgjedhore për zbatimin e procesit zgjedhor, përmirsimin e funksionimit dhe organizimit të brendshëm si edhe integrimin e aspekteve gjinore në aktivitetet e KSHZ-së.

Shpresojm që me zbatim të sukseshëm të këtij plani të kontribuojmë në realizimin e zgjedhjeve të drejta dhe demokratike, duke respektuar të gjitha të drejtat demokratike.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
Kryetar
Prof. d-r Aleksandar Dashtevski



VIZIONI i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve si institucion i pavarur dhe profesional gjatë punës së tij udhëhiqet në pajtim me Kushtetutën , ligjet si dhe konventat dhe standardet ndërkombëtare të pranua përgjithësisht dhe praktikat e mira në zgjedhje. Në hap me trendet botërore , KSHZ-ja, vendos teknologji të reja në procesin zgjedhor. Përmes zbatimit efikas dhe efektiv të procesit zgjedhor, KSHZ-ja siguron të gjithë palët të kenë qasje të barabartë deri në realizimin e të drejtave së tyre zgjedhore.

MISIONI i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, garanton të drejtë vote të barabartë, universale dhe të drejtpërdrejtë, e cila realizohet në zgjedhje të lira me votim të fshehtë dhe siguron kushte të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, me anë të zbatimit të suksesshëm të zgjedhjeve vendos fundamentin e demokracisë dhe kontribuon në rritjen e besimit në procesin zgjedhor, si dhe në institucionet demokratike të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

KUSHTETUTSHMËRIA DHE LIGJSHMËRIA në punë

KSHZ-ja, gjatë punës së saj zbaton Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe i respekton standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira zgjedhore.

Anëtarët e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve

Aleksandar Dashtevski - Kryetar
Ditmire Shehu - Nënkryetar
Boris Kondarko - Anëtar
Oliver Ristovski - Anëtar
Radica Risteska - Anëtar
Boban Stojanoski - Anëtar
Krenar Loga - Anëtar

HYRJJE

Plani strategjik i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejshëm: "KSHZ") i referohet periudhës 2021 – 2024 dhe paraqet udhërrëfyes të llojit të vet i cili drejton punën e KSHZ-së përmes drejtimeve strategjike, objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në të.

Kompleksiteti dhe rrethanat e imponuara nga pandemia KOVID-19 ndikoi në përgatitjen e planit, por nuk e pengoi pjesmarrjen e procesit.

Gjegjësisht, në përgatitjen e këtij dokumenti aktivisht morën pjesë Kryetari dhe anëtarët e KSHZ-së, si dhe të punësuarit në shërbimit profesional të KSHZ-së, përmes:

- Analizës së rezultateve të arritura, përmbushjes së zotimeve dhe aktiviteteve nga plani strategjik i mëparshëm
- Pjesëmarrjes në punëtorinë një ditore (nëntor 2020) në mënyrë që të rishikojë misionin, vizionin dhe vlerat e KSHZ-së, si dhe zbatimin e analizës SWOT dhe rishikimin e prioriteteve strategjike
- Pjesëmarrjes në punëtorinë dy ditore (25 dhe 26 Shkurt 2021) gjatë së cilës u finalizuan prioritetet e vendosura strategjike dhe u vendos prioritet i ri strategjik shtesë, si dhe aktivitete dhe objektiva strategjike që do të çojnë në përmbushjen e këtyre përrioriteteve. Në puntori në mënyrë plotësuese u rishikuan dhe u vendosën treguesit që do të matin suksesin e këtyre aktiviteteve.
- Dhënies së kontributit shtesë në mënyrë që të finalizohet projektverzioni i përgatitur i planit strategjik.

Rezultat i aktiviteteve të mësipërme është ky Plan strategjik i cili tregon në detaje se si dhe me cilat veprime KSHZ-ja do të përpiqet të zbatojë strategjinë e saj katërvjeçare.



OBJEKTIVI I PLANIT STRATEGJIK TË KSHZ-SË PËR PERIUDHËN 2021 - 2024

Objektivi kryesor i planit strategjik është të përcaktojë një strategji afatmesme, katërvjeçare për avancimin e punës së KSHZ-së përmes një sistemit zgjedhor të besueshëm, përmirësim të vazhdueshëm të procesit zgjedhorë dhe mbështetje të vazhdueshme nga të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje në realizimin e të drejtave të tyre zgjedhore. Duke vepruar kështu, KSHZ do të vazhdojë të punojë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira për realizim cilësor të proceseve zgjedhore, të garantojë profesionalizmin dhe pavarësinë e saj, të forcojë kapacitetet e saja dhe të rrisë informimin e publikut, si dhe të sigurojë qasje të barabartë gjinore në të gjitha sferat e kompetencave të saja.

Për të arritur këtë, Plani strategjik i KSHZ-së, për vitet 2021-2024 përmban shtatë prioritetet e mëposhtme, të cilat janë në përputhje me misionin, vizionin dhe fokusin e veprimit të KSHZ-së:

- 1.** Rritja e cilësisë së akteve nënligjore dhe zbatimi i tyre efikas
- 2.** Përmirësimi i mënyrës dhe procedurës për mbajtjen e listës zgjedhore
- 3.** Përmirësimi i efikasitetit të aktiviteteve ndërmjet organeve zgjedhore
- 4.** Rritja e vetëdijes, njohurisë dhe besimit të qytetarëve për procesin zgjedhor
- 5.** Avancimi i njohurive dhe shkathtësive të administratës zgjedhore për zbatimin e procesit zgjedhor
- 6.** Përmirësimi i organizimit dhe funksionimit të brendshëm
- 7.** Integrimi i aspekteve gjinore në aktivitetet e KSHZ-së

PASQYRË E PRIORITETEVE DHE OBJEKTIVAVE

PER PERIUDHËN 2021 - 2024

PRIORITETI 1

RRITJA E CILËSISË SË AKTEVE NËNLIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE EFIKAS

Me gritjen e cilësisë së akteve nënligjore të miratuara nga ana e KSHZ-së, do të vendosen procedura të qarta dhe precize gjatë veprimit nga ana e Komisionit. Me zbatimin e tyre do të avancohet funksionaliteti dhe efikasiteti do të përmirsohet kualiteti i punës së KSHZ-së, do të rritet transparencja, hapja dhe llogaridhënia, si dhe profesionalizmi, paanshmëria dhe depolitizimi në punën e KSHZ-së. Në këtë mënyrë do të rritet besimi i publikut dhe i të gjithë palëve të interesuara në KSHZ dhe në proceset zgjedhore.

Ngritja e cilësië së akteve nënligjore dhe zbatimi i tyre efektiv është prioritet i cilil dotë kontribuon në avancimin e përbushjes së objektivave të cilat janë vendosura në drejtim të përmirësimit të punës së organeve zgjedhore. Sistematizimi i rregullave dhe përpunimi i regjistrit për secilën palë të zgjedhjeve do të përmirësojë monitorimin e akteve nënligjore ndryshimin dhe plotësimin e tyre në kohë, dhe me këtë do të arrihet të jenë të disponueshme dhe më lehtë të zbatueshme nga ana e të gjithë pjesëmarrësve në procesin zgjedhorë.

Për realizimin e këtyre prioriteteve, KSHZ-ja vendosi objektivat në vijim:

- Objektiva 1.1** Avancimi i procedurës për miratimin e akteve nënligjore nga ana e KSHZ-së.
- Objektiva 1.2** Sistemimi i rregulloreve të duhura zgjedhore dhe mundësimi i tyre që të jenë më të arritshëm për zbatim për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor



PRIORITETI 2

PËRMIRSIMI I MËNYRËS DHE PROCEDURËS PËR UDHËHEQJEN E LISTËS ZGJEDHORE

Duke përmirësuar mënyrën dhe procedurën për udhëheqjen e listës zgjedhore dhe të obejktivave të vendosura për realizimin e këtij prioriteti, do të rrubullakësohet detyrimi ligjor për marrjen e plotë të listës zgjedhore nga KSHZ-ja. Gjegjesisht, edhe pse ligji thotë që Lista zgjedhore udhëhiqet nga KSHZ-ja, përpunimin organizativo-teknik dhe metodologjik të të njëjtit e udhëheq Enti Shtetërorë i Statistikës i ngarkuar me këtë aktivitet në pajtim me nenin 194 paragrafi 2 të Kodit zgjedhor.

Përpunimi i zgjidhjes së veçantë softuerike për menaxhimin e të dhënave të votuesve (VIMS) është në fazën e përfundimtare, në të cilën do të integrohen të gjitha aktivitetet dhe përpjekjet e KSHZ-së në drejtim të azhurnimit plotësues të saktësisë së të dhënave në Listën zgjedhore.

KSHZ-ja, e cila është e vetmja përgjegjëse për udhëheqjen dhe azhurnimin e listës zgjedhore dhe të drejtës zgjedhore, ka për detyrë të përmirësojë vazhdimisht procesin dhe mënyrën e udhëheqjes dhe azhurnimit të listës zgjedhore. Për më tepër, shkëmbimi i informacioneve me institucionet e tjera do të kontribuojë në saktësinë dhe në azhurnitetin e listës zgjedhore e që do të ketë efekt pozitiv dhe do të rezultojë në rritjen e besimit të publikut dhe të gjithë pjesëmarrësve në listën zgjedhore dhe të zgjedhjeve në tërësi.

Për të realizuar këtë prioritet, KSHZ-ja, vendosi objektivin në vijim:

Objektiva 2.1 Krijimi i sistemit për regjistrimin e të drejtës së votës dhe udhëheqjen e listës zgjedhore

PRIORITETI 3

PËRMIRSIMI I EFIKASITETIT TË AKTIVITETEVE NDËRMJET ORGANEVE ZGJEDHORE

Duke përmirësuar efikasitetin e aktiviteteve ndërmjet organeve zgjedhore, kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e efikasitetit të vetë procesit zgjedhor. Kjo, mbi të gjitha, do të arrihet duke përmirësuar procesin e dorëzimit, marrjes dhe ruajtjes së materialit zgjedhor, duke arritur standardizimin e tij,

përmes përmirësimit të shërbimeve të ofruara në KSHZ gjatë zgjedhjeve, por edhe duke rritur koordinimin dhe komunikimin me nivelet më të ulëta të organeve zgjedhore dhe njësive rajonale.

Për të realizuar këtë prioritet, KSHZ-ja, vendosi objektivat në vijim:

- Objektiva 3.1** Përmirësim të dorëzimit, pranimit dhe ruajtjes së materialeve zgjedhore
- Objektiva 3.2** Përmirësim të cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të ofruara për KSHZ-në gjatë zgjedhjeve
- Objektiva 3.3** Koordinim dhe komunikim të shtuar me nivelet më të ulëta të organeve zgjedhore dhe njësive rajonale të KSHZ-së

PRIORITETI 4

RRITJA E VETËDIJES, NJOHURIVE DHE BESUESHMËRISË SË QYTETARËVE PËR PROCESIN ZGJEDHOR

Ndërgjegjësimi, njohuria dhe besimi i shtuar i qytetarëve në procesin zgjedhor është thelbësore për KSHZ-në. Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje u jep më shumë rëndësi dhe legjitimitet proceseve demokratike në vend që vijnë nga votimi (formimi i qeverisë, kryetari i shtetit, etj.). Rritja e njohurive të qytetarëve në lidhje me procesin zgjedhor u mundëson atyre që të njihen më mirë me të drejtat dhe detyrimet e tyre në lidhje me procesin zgjedhor, si dhe në lidhje me procedurat dhe funksionimin e organeve zgjedhore. Kjo, nga ana tjetër, do të çonte në eliminimin e parregullsive të mundshme që mund të rezultojnë nga njohja e pamjaftueshme e procesit. Rritja e vetëdijes dhe njohurisë së qytetarëve do të kontribuojë gjithashtu në rritjen e besimit të qytetarëve të KSHZ-ja.

Për të realizuar këtë prioritet, KSHZ vendosi objektivat në vijim:

- Objektiva 4.1** Përgatitje të programeve të reja për edukimin e qytetarëve dhe votuesve
- Objektiva 4.2** Përdorime të teknikave dhe metodave të reja për edukimin e qytetarëve dhe votuesve



PRIORITETI 5

PËRMIRSIMI I NJOHURIVE DHE AFTËSIVE TË ADMINISTRATËS ZGJEDHORE PËR ZBATIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR

Me njohuritë dhe aftësitë e përmirësuara të administratës zgjedhore, KSHZ-ja do të sigurojë respektim konsekuent të të gjitha dispozitave ligjore të Kodit zgjedhor. Administrata zgjedhore do të marrë njohuri dhe aftësi për t'iu përgjigjur sfidave të mundshme në kohën e duhur para, gjatë dhe pas zgjedhjeve

Duke përbushur këtë prioritet, KSHZ-ja pret që të ketë një bazë të forcuar të trajnuesve të cilët kanë nivel të duhur të aftësive dhe njohurive, në mënyrë që të jenë në gjendje të arsimojnë të gjithë administratën zgjedhore (mbi 36,000 njerëz) në një periudhë shumë të shkurtër kohore, përmes një trajnimit të unifikuar gjithëpërfshirës.

Për të realizuar këtë prioritet, KSHZ-ja vendosi objektivat në vijim:

Objektiva 5.1 Avancimin e programeve, teknikave dhe metodave për edukimin e administratës zgjedhore

Objektiva 5.2 Zhvillim të vazhdueshëm profesional për edukatorët

PRIORITETI 6

PËRMIRSIM I ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM DHE FUNKSIONIMIT TË KSHZ-së

Përmirësimi i organizimit të brendshëm dhe funksionimit të KSHZ-së është në korrelacion të drejtpërdrejtë me përbushjen pa pengesa të misionit të saj. Prandaj, prioriteti i gjashtë kërkon të përmirësojë strukturën organizative dhe shpërndarjen e përgjegjësive dhe detyrave në shërbimin profesional të KSHZ-së përmes futjes së procedurave të brendshme për proceset kryesore të punës, duke rregulluar punën e trupave ndihmëse dhe duke vendosur një qasje metodologjike për menaxhimin e burimeve njerëzore që do të përmirësojnë menaxhimin e brendshëm në KSHZ-së. E gjithë kjo do të mbështetet nga infrastruktura e përmirësuar adekuate e Teknologjisë Informatike dhe të Komunikimit (TIK-ut) dhe vendosja e standardeve adekuate të sigurisë.

Për të realizuar këtë prioritet, KSHZ-ja vendosi objektivat në vijim:

- Objektiva 6.1** Përmirësimin e strukturës organizative dhe shpërndarjen e përgjegjësive në shërbimin profesional të KSHZ-së
- Objektiva 6.2** Vendosjen e sistemit për menaxhim me shërbimin profesional gjatë procesit zgjedhor
- Objektiva 6.3** Përmirësimin e menaxhmentit të brendshëm dhe komunikimit horizontal edhe vertikal
- Objektiva 6.4** Përmirësimin e infrastrukturës së TIK-ut, sistemeve të rrjetëzuara dhe interoperabile dhe rritjen e sigurisë së sistemeve të TIK-ut
- Objektiva 6.5** Proces bashkëkohor të planifikimit, menaxhimit dhe njoftimit për resurset financiare të KSHZ-së

PRIORITETI 7

INTEGRIM TË ASPEKTEVE GJINORE NË AKTIVITETET E KSHZ-së

Praktikat ndërkombëtare tregojnë se komisioni zgjedhor që integron aspekte të barazisë gjinore në punën e tij mund të luajë një rol të rëndësishëm në rritjen e pjesëmarrjes së grave në procesin zgjedhor. Për KSHZ-në, përfshirja e aspekteve gjinore dhe integrimi i praktikave të ndjeshme gjinore janë risi dhe me këtë plan strategjik vendosen për herë të parë, si shprehje e gatishmërisë së institucionit për të njejtët.

Për të realizuar këtë prioritet, KSHZ-ja vendosi objektivat në vijim:

- Objektiva 7.1** Integrimin e aspekteve gjinore në funksionimin e brendshëm të KSHZ-së
- Objektiva 7.2** Integrimin e aspekteve gjinore në aktivitetet zgjedhore të KSHZ-së



PASQYRË E AKTIVITETEVE DHE INDIKATORËVE

PËR PERIUDHËN 2021-2024

PRIORITETI 1 – RITJIA E CILËSISË SË AKTEVE NËNLIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE EFIKAS		
OBJEKTIVI	AKTIVITETI	INDIKATORËT
Objektivi 1.1 Avancimi i procedurës për miratimin e akteve nënligjore nga KSHZ-ja	1.1.1 Vendosija e sistemit për vlerësim dhe zbatueshmëri të akteve nënligjore	1.1.1.1 <i>Procedurë / metodologji e përgatitur dhe e miratuar për vlerësimin e zbatueshmërisë së akteve nënligjore</i>
		1.1.1.2 <i>Trajnim i mbajtur për punonjësit për të zbatuar procedurën për vlerësimin e zbatueshmërisë së akteve nënligjore</i>
	1.1.2 Rritja e transparencës, përfshirjes dhe efikasitetit të procedurës së KSHZ-së për miratimin e akteve nënligjore	1.1.2.1 <i>Numri i konsultimeve me palët</i>
		1.1.2.2 <i>Numër i formularë për zgjedhjet të vënë në dispozicion për publikun, përfshirë edhe partitë politike, shoqërinë civile dhe votuesit (përmes veb faqes së KSHZ-së, distribuimi elektronik, informimi medial, edukimi etj.).</i>
	1.1.3 Monitorim të përhershëm të akteve nënligjore plotësimin dhe ndryshimin e tyre	1.1.3.1 <i>Numri i akteve nënligjore të ndryshuara</i>
		1.1.3.2 <i>Numri i akteve nënligjore të plotësuara</i>
1.1.3.3 <i>Numri i akteve nënligjore të ndryshuara dhe plotësuara</i>		
Objektivi 1.2 Sistematizimi i akteve juridike zgjedhore dhe mundësimin të njejtat të jenë më të disponueshme për zbatim për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor	1.2.1 Pasqyrë e akteve sipas zbatueshmërisë	1.2.1.1 <i>Numri i analizave të realizuara</i>
	1.2.2 Përgatitje të regjistrit sipas llojeve të zgjedhjeve	1.2.2.1 <i>Regjistri i përgatitur</i>
	1.2.3 Mundësimi për qasje të lehtësuara te aktet zgjedhore për pjesëmarrësit në procesin zgjedhor	1.2.3.1 <i>Është vendosur bazë e rregullave gjithëpërfshirëse dhe të azhurnuar</i>
		1.2.3.2 <i>Është krijuar mjet funksional elektronik për kërkim dhe qasje të lehtë në rregulloret zgjedhore</i>

PRIORITETI 2 – PËRMIRSIMI I MËNYRËS DHE PROCEDURËS PËR UDHËHEQJEN E LISTËS ZGJEDHORE

OBJEKTIVI	AKTIVITETI	INDIKATORËT
Objektivi 2.1 Krijimi i sistemit për regjistrimin e të drejtës së votës dhe udhëheqjen e listës zgjedhore	2.1.1 Krijimi i sistemit funksional informatik për përpunim organizativo-teknik dhe metodologjik të Listës zgjedhore dhe menaxhimi elektronik me të dhënat e zgjedhësve, vendvotimet dhe njësitë zgjedhore	2.1.1.1 <i>Është vën në funksion sistemi informatik për përpunimin organizativ-teknik dhe metodologjik të Listës zgjedhore për zgjedhjet e ardhshme</i>
		2.1.1.2 <i>Numri I trajnimeve për të punësuarit në KSHZ për aplikim të sistemit</i>
	2.1.2 Harmonizim të akteve nënligjore për azhurnimin e listës zgjedhore	2.1.2.1 <i>Numri i akteve nënligjore të harmonizuara</i>
	2.1.3 Krijimi i kushteve për këmbimin e të dhënave me institucionet relevante në kuadër të sistemit për interoperabilitet	2.1.3.1 <i>Numri i memorandumeve të arritura për bashkëpunim në pjesën e këmbimit të dhënave me institucione, varësisht nga implementimi i sistemit për interoperabilitet</i>
2.1.4 Avancimi i procedurës dhe i sistemit për paraqitje për votim jashtë vendit.	2.1.4.1 <i>Procedurë e reviduar dhe miratuar për paraqitje për votim jashtë vendit në përputhje me sistemin e vendosur informatik për përpunimin organizativo-teknik dhe metodologjik të Listës zgjedhore</i>	



PRIORITETI 3 – PËRMIRËSIMI I EFIKASITETIT DHE EFEKTIVITETIT TË VOTIMIT DHE OPERACIONEVE ZGJEDHORE

OBJEKTIVI	AKTIVITETI	INDIKATORËT
Objektivi 3.1 Përmirësimi i procesit të dorëzimit , pranimit, dhe ruajtjes së materialit zgjedhor	3.1.1 Vendorsja e procedurave të shkruara për pranim-dorëzim të materialit zgjedhor nga KSHZ-ja te KKZ-ja; KKZ-ja te KZ-ja dhe anasjelltas; KKZ-ja te KSHZ-ja	<i>3.1.1.1 Numri i procedurave të përgatitura</i>
Objektivi 3.2 Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të ofruara për KSHZ-në gjatë zgjedhjeve	3.2.1 Realizimi i furnizimeve të nevojshme në kohë dhe në mënyrë transparente	<i>3.2.1.1 Numri i procedurave për furnizime me negociim të drejtpërdrejtë pa publikim paraprak të shpalljes</i>
Objektivi 3.3 Koordinim dhe komunikim i rritur me nivelet më të ulta të organeve zgjedhore dhe njësisë rajonale të KSHZ-së	3.3.1 Përcaktimi i procedurës - me udhëzime ose me kahje - për komunikim të KSHZ-së me KKZ-të dhe KZ-të	<i>3.3.1.1 Procedura e përcaktuar për komunikim</i>

PRIORITETI 4 – RRTIJA E VETËDIJËSIMIT DHE NJOHURIVE TË QYTETARËVE PËR PROCESIN ZGJEDHOR

OBJEKTIVI	AKTIVITETI	INDIKATORËT
Objektiva 4.1 Përgatitja e programeve të reja për edukimin e qytetarëve dhe votuesve	4.1.1 Përmirësimi i programeve për edukimin e qytetarëve dhe zgjedhësve, përfshirë edhe programet e përshtatura për kategori të veçanta të votuesve	4.1.1.1 Përmirësimi i programeve për edukimin e qytetarëve dhe zgjedhësve, për mënyrën e votimit dhe realizimin e të drejtës së votës
		4.1.1.2 Programe të përmirsuara për edukimin e kategorive të veçanta të votuesve
	4.1.2 Certifikimi i fushatave për edukimin dhe informimin e qytetarëve	4.1.2.1 Numri i kampanjave të certifikuara
		4.1.3 Përgatitja e fushatave për komunikim të drejtëpërdrejtë me publikun për informimin parazgjedhor të qytetarëve dhe transmetimi në mediet përkatëse
	4.1.3.1 Numri i fushatave për informim parazgjedhor të qytetarëve dhe zgjedhësve	4.1.3.2 Numri i medimeve që i transmetojnë fushatat
		4.1.3.3 Numri i materialeve informuese të përgatitura për zgjedhësit
		4.1.3.4 Numri i materialeve të përgatitura për grupet e veçanta të zgjedhësve
		4.1.3.5 Numri i materialeve të shpërndara
		4.1.3.6 Numri i videove të zhvilluara
		4.1.3.7 Numri i simulimeve të zhvilluara
		4.1.4 Krijimi i fushatës për forcimin e besimit të qytetarëve në Listën zgjedhore dhe bashkëpunimi i tyre gjatë menaxhimit dhe azhurnimit të Listës zgjedhore
	4.1.4.2 Përqindja e qytetarëve me besim të shtuar në KSHZ-në	
	4.1.4.3 Numri i medimeve që i transmetojnë fushatat	
4.1.4.4 Numri i brifingjeve/ prezantimeve me grupet e synuara për çështje lidhur me listën zgjedhore		



PRIORITETI 4 – RITJIA E VETËDIJËSIMIT DHE NJOHURIVE TË QYTETARËVE PËR PROCESIN ZGJEDHOR		
OBJEKTIVI	AKTIVITETI	INDIKATORËT
Objektiva 4.2 Përdorimi i teknikave dhe metodave të reja për edukimin e qytetarëve dhe votuesve.	4.2.1 Avancimi i materialeve informative për edukimin e qytetarëve (video, regjistrime, posterë, fletushka etj.)	4.2.1.1 Numri i materialeve edukative dhe informative të miratuara dhe të shfaqura/shpërndara
		4.2.1.2 Numri i medimeve përmes të cilave është shpërndarë material edukativ dhe informues
		4.2.1.3 % e të anketuarve që kanë marrë pjesë në anketa dhe të cilët u shprehën pozitivisht në lidhje me materialet informuese për edukim
	4.2.2 Krijimi dhe përditësimi i rregullt i faqeve elektronike dhe rrjeteve sociale (facebook, twitter), gjatë kohës së procesit zgjedhor dhe ndërmjet zgjedhjeve;	4.2.2.1 Numri i postimeve të publikuara në faqen e Fejsbuk-ut (Facebook) të KSHZ-së në bazë javore gjatë kohës së periudhës zgjedhore
		4.2.2.2 Numri i postimeve të publikuara në faqen e tviter-it (Twitter) të KSHZ-së në bazë javore gjatë kohës së periudhës zgjedhore
		4.2.2.3 Numri i postimeve të publikuara në faqen e Fejsbuk-ut (Facebook) të KSHZ-së në bazë javore gjatë periudhës ndërmjet zgjedhjeve
		4.2.2.4 Numri i postimeve të publikuara në faqen e tviter-it (Twitter) të KSHZ-së në bazë javore gjatë periudhës ndërmjet zgjedhjeve
4.2.3 Krijimi dhe publikimi periodik i buletinit elektronik për aktivitetet e KSHZ-së;	4.2.3.1 Numri i buletineve elektronike të publikuara në bazë vjetore për aktivitetet e KSHZ-së	

PRIORITETI 5 – AVANCIMI I NJOHURIVE DHE SHKATHTËSIVE TË ADMINISTRATËS ZGJEDHORE PËR ZBATIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR

OBJEKTIVI	AKTIVITETI	INDIKATORËT
Objektiva 5.1 Avancimi i programeve, teknikave dhe metodave për edukimin e administratës zgjedhore	5.1.1 Përditësimi i programeve për edukimin e administratës zgjedhore	5.1.1.1 Numri i programeve të miratuara për edukim të qytetarëve dhe zgjedhësve
	5.1.2 Avancimi i materialeve për edukimin e administratës zgjedhore (doracak, video doracak, prezantime, onlajn kurse...)	5.1.2.1 Numri i programeve të miratuara për edukimin e administratës zgjedhore
		5.1.2.2 % e të anketuarve të cilët kanë dhënë vlerësim maksimal për materialet edukuese
	5.1.3 Vendosja e veglave kreative për edukim të vazhdueshëm, interaktiv dhe të individualizuar të administratës zgjedhore (psh. Webinar, onlajn teste)	5.1.3.1 Numri i veglave kreative për edukim të vendosura në funksion
		5.1.3.2 Numri i vebinareve të miratuara zhvilluara dhe të shpallura në ueb faqen e KSHZ-së
5.1.3.3 Numri i shfrytëzuesve të aktvendimeve onlajn.		
5.1.4 Certifikimi i trajnimeve që KSHZ-ja i zbaton për anëtarët e organeve zgjedhore të niveleve më të ulta	5.1.4.1 Numri i trajnimeve të çertifikuara për edukimin të organeve zgjedhore të vendosura në funksion	
Objektiva 5.2 Zhvillim i vazhdueshëm profesional për edukatorë	5.2.1 Realizimi i trajnimeve për edukatorë	5.2.1.1 Numri i trajnimeve të realizuara për edukatorë
	5.2.2 Avancimi i programës për trajnim trajnim avancues për edukatorë	5.2.2.1 Është krijuar program i avancuar për trajnim të vazhdueshëm të edukatorëve para zgjedhjeve të ardhshme
		5.2.2.2 Është krijuar program i avancuar për trajnimin e avancuar të vazhdueshëm të edukatorëve para zgjedhjeve të ardhshme
	5.2.3 Shfrytëzimi i metodologjisë BRIDGE (Building Resources in Democracy, Governance and Elections) gjatë zbatimit të trajnimeve të vazhdueshme për edukatorë	5.2.3.1 Numri i trajnimeve të realizuara duke shfrytëzuar metodologjinë BRIXH (BRIDGE)



PRIORITETI 6 – PËRMIRSIM I ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË BRENDSHËME

OBJEKTIVI	AKTIVITETI	INDIKATORËT
Objektivi 6.1 Strukturë më të mirë organizative dhe shpërndarje të përgjegjësive në shërbimin profesional të KSHZ-së	6.1.1 Miratimi dhe zbatimi i procedurave të brendshme për proceset e punës	6.1.1.1 <i>Është vendosur standardi për kualitet ISO 9001:2015</i>
Objektivi 6.2 Sistem i vendosur për menaxhim me shërbimin profesional gjatë kohës së procesit zgjedhorë	6.2.1 Vendosja e qasjes metodologjike në planifikimin dhe menaxhimin me resurset njerëzore	6.2.1.1 <i>Është zhvilluar dhe miratuar metodologjia në planifikimin dhe menaxhimin me resurset njerëzore;</i>
		6.2.1.2 <i>Janë miratuar planet vjetore për punësim në pajtim me metodologjinë e përcaktuar.</i>
	6.2.2 Vlerësimi i nevojave për trajnime dhe zbatimi i programit funksional për trajnime të specializuara të punësuarve	6.2.2.1 <i>Vlerësimi i realizuar i nevojës për trajnim i përditësuar në bazë vjetore</i>
		6.2.2.2 <i>Janë identifikuar mundësitë e brendshme dhe të jashtme dhe burimet financiare për pjesëmarrje dhe / ose organizim të trajnimeve të specializuara</i>

PRIORITETI 6 – PËRMIRSIM I ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË BRENDSHËME

OBJEKTIVI	AKTIVITETI	INDIKATORËT
<p>Objektivi 6.3 Menaxhment më të mirë të brendshëm dhe komunikimi horizontal dhe vertikal</p>	6.3.1 Miratimi dhe implementimi efektiv i Rregullores së re për punën e KSHZ-së	6.3.1.1 <i>Është miratuar Rregullore e re e KSHZ-së.</i>
	6.3.2 Zhvillimi i sistemit për komunikim vertikal dhe horizontal dhe informimi ndërmjet të punësuarve, sipas procedurave dhe standardeve të përcaktuara të brendshme	6.3.2.1 <i>Sistem i avancuar i lëvizjes elektronike të dokumenteve</i>
	6.3.3 Zbatimi i planit strategjik dhe vjetorë të punës për revision të brendshëm të KSHZ-së	6.3.3.1 <i>Numri i raporteve nga revizionet e kryera në pajtim me planet e miratuara vjetore të revizionit në KSHZ</i>
		6.3.3.2 <i>% e rekomandimeve të dhëna që janë zbatuar</i>
	6.3.4 Vendosja e një sistemi të qartë për motivim të të punësuarve	6.3.4.1 <i>Mekanizmat e përcaktuara dhe të implementuara për motivim të të punësuarve</i>
		6.3.4.2 <i>Mekanizmat e zbatuara për motivim të të punësuarve në bazë vjetore gjatë procesit zgjedhjeve.</i>



**PRIORITETI 7 – INTEGRIM TË ASPEKTEVE GJINORE NË AKTIVITETET
E KSHZ-së**

OBJEKTIVI	AKTIVITETI	INDIKATORËT
Objektivi 7.1 Integrimi i aspekteve gjinore në funksionimin e mbrenshëm të KSHZ-së	7.1.1 Miratimi i planit akcional për barazi gjinore	<i>7.1.1.1 Plani i miratuar akcional për barazi gjinore</i>
	7.1.2 Senzibilizim gjinor dhe trajnime për ngritjen e vetëdijes për çështjet gjinore	<i>7.1.2.1 Numri i trajnimeve të mbajtura</i>
		<i>7.1.2.2 % e punonjësve të trajnuar</i>
7.1.3 Miratimi i politikave mundësi të barabarta	<i>7.1.3.1 Politika e miratuar për mundësi të barabarta</i>	
Objektivi 7.2 Integrimi i aspekteve gjinore në aktivitetet zgjedhore të KSHZ-së	7.2.1 Shfaqja e të dhënave ndaras sipas gjinisë në procesin zgjedhorë (votuesit, kandidatët, të zgjedhurit)	<i>7.2.1.1 Numri i kategorive të të dhënave që paraqiten si të ndara sipas gjinisë</i>
	7.2.2 Miratimi i strategjisë komunikuese për integrimin e aspekteve gjinore	<i>7.2.2.1 Strategjia e miratuar e komunikimit për integrimin e aspekteve gjinore në aktivitetet zgjedhore të KSHZ-së</i>

KORNIZA PËR MONITORIMIN DHE REVIZIONIN E PLANIT STRATEGJIK

Që të mund monitorohet në mënyrë efektive dhe të vazhdueshme realizimi i objektivave të përcaktuara në Planin strategjik përkaj përkuftizimit të objektivave dhe aktiviteteve si edhe indikatorëve dhe determinuesve vjetorë (targetëve) dhe aktiviteteve të nivelin strategjik KSHZ-ja do të bëjë plane të detajuara vjetore në të cilat do të renditen qëllimet dhe aktivitetet mbi baza vjetore.

Qasja e këtillë përfshin aktivitetet e mëposhtme për monitorim dhe evalvim:

- Raporte vjetore për zbatimin e aktiviteteve të Planit strategjik nga sektorë relevantë dhe njësi pranë KSHZ-së, të parashtruara deri te seksioni i pavarur për planifikim strategjik dhe analiza.
- Planet vjetore, në fund të çdo viti, në muajin dhjetor, sektorët e KSHZ-së përgjegjëse për zbatimin e prioriteteve përkatëse nga Plani strategjik, do të dorëzojnë deri te Seksioni i pavarur për planifikim Planet strategjike përbëhen nga aktivitete të cilët sektorët e KSHZ-së planifikojnë ti zbatojnë gjatë vitit të ardhshëm si rezultat i planeve aksionare të Planit strategjik, me afat konkret dhe subjekte me të cilët do të bashkëpunojë në zbatimin e masave.
- Raport vjetor i dorëzuar në KSHZ nga seksioni i pavarur për analizë dhe planifikim strategjik, për realizimin e aktiviteteve nga Plani strategjik dhe aktivitetet e propozuara të cilët sektorët e KSHZ-së planifikojnë t'i realizojnë gjatë vitit të ardhshëm.


Metodologjia për revizion të Planit strategjik do të parashikojë përshtatjen e planeve aksionare dhe propozimeve për masat prioritare në përputhje me rekomandimet nga zbatimi dhe nevojat. Kjo nënkupton:

- Metodologji dhe afate për zhvillimin e planit të dytë operativ për vitin 2022 .



- Metoda për konsultimin e progresit sipas raporteve të Unionit Evropian dhe organizatave ndërkombëtare, të përgatitura nga Sektori për çështje juridike dhe normative dhe Seksioni i pavarur për planifikim strategjik dhe analiza, duke përgatitur formular për formën dhe përmbajtjen e raporteve vjetore për zbatimin e masave të planit strategjik.
- Vlerësime dhe analiza vjetore për proceset e vlerësimit të zbatimit të planit strategjik.

Vlerësimi i zbatimit të Planit strategjik do të kryhet një herë në vit përmes ekipit të propozuar nga anëtarët e KSHZ-së, në bashkëpunim me Sekretarin e përgjithshëm të KSHZ-së. Rezultatet nga vlerësimi do të përmbajnë analizë të zbatimit të deri atëherëshëm, informacione për objektivat e arritura dhe rekomandimet për ndryshimin dhe përshtatjen e planeve operative. Raportet dhe planet do të jenë në dispozicion në ueb faqen e KSHZ-së.



SHTOJCAT



PARIMET E PUNËS SË KSHZ-SË

PARTNERITETET DHE BASHKËPUNIMI

Gjatë realizimit të kompetencave të përcaktuara ligjore, KSHZ-ja në pajtim me Kodin zgjedhorë dhe bazuar në besimin realizon partneritetet dhe bashkëpunim me të gjithë palët në procesin zgjedhorë edhe atë:

- Ministria e Financave, aprovon mjete financiare për zbatimin e zgjedhjeve dhe referendumeve dhe për aktivitete të rregullta të KSHZ-së.
- Ministria e Drejtësisë, ose më sakt zyrat e vendit të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë për evidencën amë gjatë kohës së ciklit zgjedhor kanë rol për grumbullimin e nënshkrimeve dhe këqyrjes publike në listën zgjedhore.
- Ministria e Punëve të Brendshme, dorëzon të dhëna për përpunimin e listës zgjedhore gjatë azhurimit të rregullt dhe kur shpallen zgjedhjet. Gjatë kohës së zgjedhjeve, gjithashtu e siguron shpërndarjen e materialit zgjedhor, i siguron vendvotimet, e mban rendin dhe qetësinë publike dhe siguron transportin e fletëvotimeve nga/deri KKZ-të deri/nga KSHZ-ja.
- Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, dorëzon listat e të punësuarve në administratën shtetërore dhe publike prej të cilëve bëhet përzgjedhja e anëtarëve të organeve zgjedhore KKZ dhe KZ dhe e cila është kompetente dhe udhëheqë Regjistrin qendror të popullatës.
- Ministria e Punëve të Jashtme me të cilën realizohet bashkëpunim lidhur me votimin në diasporë (sigurimi i mbështetjes hapësinore dhe teknike gjatë zbatimit të votimit në përfaqësitë diplomatike-konsulare dhe zyrat konsulare, distribuimi i materialeve, grumbullimi i nënshkrimeve, shikimi publik në Listën zgjedhore, paraqitjet për votim etj.
- Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit, kryen kontrolle dhe i publikon raportet financiare të marra nga partitë politike
- Enti Shtetëror i Statistikës, siguron ndihmë dhe mbështetje gjatë përpunimit metodologjik-teknik të të dhënave në listën zgjedhore dhe i shpërndan votuesit sipas vendvotimeve.

- Enti Shtetëror i Revizionit, kryen revizionin e raporteve financiare të partive politike dhe i publikon raportet financiare në veb faqen e tij.
- Agjencioni për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, miraton Metodologjinë për monitorimin e paraqitjes mediale zgjedhore përmes serviseve programore radio dhe televizive dhe medimeve elektronike (internet portalet) gjatë kohës së proceseve zgjedhore si dhe kryen monitorimin e skemës programore të medimeve.
- Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale (NJVL), sigurojnë kushte materiale dhe teknike për punën e KKZ-ve, sigurojnë dhe kryejnë pagesat e kompenzimeve financiare për punën dhe anëtarët e KKZ-ve dhe KZ-ve për zbatimin e zgjedhjeve lokale.
- Mediat para se gjithash Servisi Radiodifuziv publik RTM-ja i cili ka detyrim ligjor për publikimin e informacioneve me karakter publik, bashkëpunimi është në pjesën e informimit dhe edukimit të qytetarëve përmes publikimit në kohë të të dhënave për programet e RTM-së, para se gjithash ato janë përmbajtjet informative dhe arsimore në formën e audio dhe video spoteve, informacioneve dhe të tjera për përshkrimin e vendotimeve, procedurat për shikim në listës zgjedhore, të drejtat e qytetarëve dhe mbrojtjes së drejtës së votimit, procedurat për votim dhe të tjera sipas nevojave të KSHZ-së.
- Gjykata administrative, si organ i shkallës së dytë, përmes KSHZ-së i siguron të dhënat e nevojshme për vendosje ndaj procedurave mbi ankesat e parashtruara për mbrojtjen e të drejtës së votës dhe parregullsive zgjedhore.
- Partitë politike të cilat dorëzojnë propozime për hartimin e këshillave zgjedhorë me persona të propozuar nga partitë politike dhe regjistrimin e kandidatëve gjatë zgjedhjeve. Parashtrojnë edhe kundërshtime për procesin zgjedhor.
- Organizatat qytetare të cilat parashtrojnë kërkesa për dhënien e akreditimeve për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe respektimin e rregullave të vëzhguesve.
- Organizatat dhe institucionet ndërkombëtare në të cilat KSHZ-ja është anëtar - Asociacioni i Komisioneve Zgjedhore Evropiane (AKZE) dhe këmben informacione me OSBE/ODIHR, Komisionin e Venedikut etj.



GRUPET E SYNUARA

- Organet zgjedhore:
 - Komisionet komunale zgjedhore (KKZ)
 - Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit (KZ e QSh) dhe
 - Këshillat zgjedhorë (KZ)
- Qytetarë me të drejtë vote
- Kategori të posaçme personash (të rinjë, grupe të pambrojtura, femra, persona nga mjediset rurale dhe të pazhvilluara, të handikepuarit etj.)
- OJQ-të dhe Shoqëria civile të përfshirë në aktivitete lidhur me zgjedhjet
- Vëzhguesit ndërkombëtarë
- Përfaqësues të medimeve, vendor dhe ndërkombëtar.
- Komuniteti ndërkombëtar i pranishëm në vend

VLERAT TË CILAT I PËRFAQËSON KSHZ-JA

Pavarësia

Në punën e saj KSHZ-ja është e pavarur dhe sovrane. Është themeluar me Kodin zgjedhor. Mjetet për punë të KSHZ-së sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me këto mjete KSHZ-ja, disponon si e pavarur. Kryetarin, nënkryetarin, dhe anëtarët e KSHZ-së i emëron Kuvendi me dy të tretat e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve. Në KSHZ formohet shërbimi profesional për realizimin e punëve profesionale, administrative, organizative.

Profesionalizmi

Anëtarët e KSHZ-së mblidhen në pajtim me Kodin zgjedhorë. Të punësuarit në shërbimin profesional të KSHZ-së kanë status të nënpunësit shtetëror. Puna në KSHZ bazohet në këto principe:

- Kushtetueshmëri dhe ligjshmëri,
- transparencë,
- përgjegjësi,
- llogaridhënie,
- pavarësi,
- paanshmëri.

Në punën e saj KSHZ-ja udhëhiqet në pajtim me kushtetutën, ligjet dhe me standardet dhe konventat ndërkombëtare të pranua përgjithësisht dhe praktikat e mira në zgjedhje. Anëtarët e KSHZ-së dhe shërbimi profesional veprojnë të ndara dhe të pavarura. KSHZ-ja si oragani më i lartë zgjedhorë kujdeset për ligjshmërinë e përgatitjes dhe zbatimit të zgjedhjeve në pajtim me Kodin zgjedhorë dhe mbikqyrë punën e organeve tjera zgjedhore.



Transparenca

Puna e KSHZ-së është transparente dhe e hapur për publikun. Seancat e KSHZ-së janë publike dhe transmetohen drejtëpërsëdrejtë në kanal in jube (Youtube) të KSHZ-së. KSHZ-ja i shfrytëzon të gjitha mjetet për informimin e publikut, qytetarëve dhe pjesëmarrësve në procesin zgjedhor përmes medimeve audio dhe të shkruara dhe internet veçat, si dhe komunikimi i drejtëpërdrejtë. KSHZ-ja raportet nga realizimi i zgjedhjeve i dorëzon në Kuvendin e RMV-së dhe i shpall në ueb faqen e saj www.sec.mk.

Paanshmëria

KSHZ-ja vendos e pavarur e panshme dhe sipas fakteve të konfirmuara, në pajtim me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore. KSHZ-ja në mënyrë të përgjegjshme dhe në kohë i merr dhe zbaton të gjitha veprimet dhe aktivitetet e nevojshme që janë të domosdoshme për marrjen e vendimeve ligjore.

Përgjegjësia

KSHZ-ja rregullisht zbaton vetëevalvim me qëllim mbledhjen e përvojave për përmirsimin e procesit zgjedhor. Në këtë mënyrë rritet efikasiteti dhe efektiviteti, si dhe tejkalohen parregullsitë eventuale. Gjatë organizimit të zgjedhjeve KSHZ-ja zbaton konventat dhe standardet ndërkombëtare të pranuar përgjithësisht për çështjet zgjedhore dhe praktikatat e mira të pranuar ndërkombëtarisht.

Inkluziviteti


Puna e KSHZ-së e hapur dhe publike për të gjithë pjesëmarrësit dhe vëzhguesit në procesin zgjedhorë. Gjatë krijimit të politikave të saja KSHZ-ja bashkëpunon me institucionet dhe organet tjera shtetërore , me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare dhe me sektorin joqeveritar dhe sektorin civil, me qëllim të sigurimit të inkluzivitetit në proces.

.

KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE E KSHZ-SË


Në bazë të nenit 31 paragrafi 2 pika 27 të Kodit zgjedhor („Gz. Zyrtare e RM-së”, nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08 ,163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ numëri 98/19 dhe 42/20) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka:

- Rregullore për organizim të brendshëm dhe fushëveprimin e punës së Shërbimit profesional të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, numër 01-135/1 të datës 14. 03. 2008, numër 02- 3991/1 të datës 14. 09. 2009 dhe numër 02- 3991/8 të datës 22. 12. 2009 dhe 01-297/1 të datës 22.02.2011 dhe 04-2903/2 të datës 07.11.2019 ;
- Rregullore për sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 01-1534/1 të datës 15.10.2015 dhe
- Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 01-219/1 të datës 26.01.2016 dhe 04-2903/3 të datës 07.11.2019. Në këtë rregullore janë përcaktuar dhe përshkruar vendet e punës të nënpunësve administrativ(shtetëror) dhe personave ndihmës-teknik, të shpërndarë sipas njësive organizative në pajtim me Rregulloren për organizim të brendshëm të Shërbimit profesional të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve






ORGANOGRAMI I ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË SHËRBITIMIT PROFESIONAL TË KSHZ-SË



Në KSHZ, në zyrën qendrore në Shkup janë të punësuar 37 nëpunës shtetëror në kohë të pacaktuar dhe 3 nëpunës në kohë të caktuar deri më 31.12.2021 dhe 62 nëpunës shtetëror të punësuar në njësitë rajonale në kohë të pacaktuar.



HARTA ME NJËSI DHE ZYRA RAJONALE

LISTA E NJËSIVE DHE ZYRAVE RAJONALE:

1. Njësia rajonale Qendër dhe zyrë në komunën e Aerodromit, me kompetenca për komunat: Qendër dhe Aerodrom,
2. Njësia rajonale Kisella Vodë dhe zyrë në komunën e Zelenikovës, me kompetenca për komunat: Kisella Vodë, Sopishte, Studeniçan dhe Zelenikovë,
3. Njësia rajonale Karposh dhe zyrat në komunën e Gjorçe Petrovit dhe Sarajit, me kompetenca për komunat: Karposh, Gjorçe Petrov, dhe Saraj,
4. Njësia rajonale Çair, me kompetencë për komunën Çair,



5. Njësia rajonale Butel dhe zyrë në komunën e Shuto Orizares, me kompetenca për komunat: Butel, Shuto Orizare dhe Çučer Sandevë,
6. Njësia rajonale Gazi Babë dhe zyrat në komunën e Haraçinës dhe Petrovecit, me kompetenca për komunat: Gazi Babë, Haraçinë, Ilinden dhe Petrovec,
7. Njësia rajonale Kumanovë dhe zyrat në komunat e Kriva Pallankës, Kratovës dhe Likovës, me kompetenca për komunat: Kumanovë, Kriva Pallankë, Kratovë, Staro Nagoriçanë, Rankovcë dhe Likovë,
8. Njësia rajonale Shtip dhe zyrat në komunat e Sveti Nikollës dhe Probishtipit, me kompetenca për komunat: Shtip, Sveti Nikollë, Probishtip, Karbincë dhe Llozovë,
9. Njësia rajonale Veles dhe zyrat në komunat e Kavadarci dhe Negotinës, me kompetenca për komunat: Veles, Çashkë, Gradsko, Kavadarë, Rosoman, Negotinë dhe Demir Kapi,
10. Njësia rajonale Koçanë dhe zyrë në komunën e Vinicës, me kompetenca për komunat: Koçanë, Vinicë, Çeshinovë - Obleshevë dhe Zërnovcë,
11. Njësia rajonale Berovë dhe zyrë në komunën e Dellçevës, me kompetenca për komunat: Berovë, Pehçevë, Dellçevë, Makedonska Kamenicë,
12. Njësia rajonale Strumicë dhe zyrë në komunën e Radovishit, me kompetenca për komunat: Strumicë, Vasilevë, Bosillovë, Novo Sellë, Radovish dhe Konçe,
13. Njësia rajonale Prilep dhe zyrë në komunën e Krushevës, me kompetenca për komunat: Prilep, Krushevë, Krivogashtanë dhe Dolnenë,
14. Njësia rajonale Gjevgjeli dhe zyrë në komunën e Vallandovës, me kompetenca për komunat: Gjevgjeli, Vallandovë, Dojran dhe Bogdaci,
15. Njësia rajonale Manastir dhe zyrat në komunën e Resnjës dhe Demir Hisarit, me kompetenca për komunat: Bitollë, Resnjë, Demir Hisar, Mogillë dhe Novaci,
16. Njësia rajonale Ohër me kompetenca për komunat: Ohër dhe Debarcë
17. Njësia rajonale Kërçovë dhe zyrë në komunën e Makedonski Brodit, me kompetenca për komunat: Kërçovë, Makedonski Brod dhe Pllasnicë,
18. Njësia rajonale Strugë dhe zyrë në komunën e Dibrës, me kompetenca për komunat: Strugë, Dibër, Vevçanë, Qendra e Zhupës,

19. Njësia rajonale Gostivar dhe zyrat në komunën e Vrapçishtës dhe Mavrovë dhe Rostushë, me kompetenca për komunat: Gostivar, Vrapçishtë dhe Mavrovë dhe Rostushë,
20. Njësia rajonale Tetovë dhe zyrat në komunën e Jegunovcës dhe Bogovinjës, me kompetenca për komunat: Tetovë, Bogovinë, Bërvenicë, Zhelinë, Tearcë dhe Jegunovcës.

Nr. _____
17. 03. 2021

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
Kryetar
Aleksandar Dashtevski

